



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:036420
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05602715

C.nr.160/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve F.S., dhe SH.S., që të dy nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson T.V., për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensimin nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 4,285.22 euro, jashtë seance me datë 22.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.S., dhe SH.S që të dy nga Komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësve të lartcekur, të ia paguajë:

- Paditëses F.S., në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 19.12.2019 e deri me datë 09.02.2022, respektivisht për 323 ditë të pranisë në punë, në shumën e prej 646.00.-€ dhe në emër të kompensimit nga marrëdhënia e punës, mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë, për 23 muaj, për periudhën kohore 22.02.2019 deri me datë 21.01.2021, të ia paguaj shumën prej 1,273.05.-€;
- Paditësit SH.S në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 19.12.2019 e deri me datë 09.02.2022, respektivisht për 323 ditë të pranisë në punë, në shumën e prej 646.00.-€ dhe në emër të kompensimit nga marrëdhënia e punës, mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë, për 23 muaj, për periudhën kohore 22.02.2019 deri me datë 21.01.2021, të ia paguaj shumën prej 1,496.61.-€;

Të gjitha shumat e lartcekura, në shumë të përgjithshme prej 4,061.66 -€ (katërmijë e gjashtëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 22.02.2022 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 332.00.-€ (treqind e tridhjetë e dy euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit F.S., dhe SH.S, që të dy nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 22.02.2022, përmes të autorizuarve të tyre Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, avokatë në Prishtinë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensimin nga marrëdhënia e punë mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune me të paditurën. Të njëjtit nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe për kompensimin nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit andaj ka paraqitur padi ku ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëjë pagesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensimit nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit. Paditësit përmes të autorizuarve të tyre avokat Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj kanë bërë precizimin e kërkesëpadiisë me datë 29.11.2023 ku kanë kërkuar të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve të ushqimit në vendin e punës për periudhën nga 19.12.2019- 09.02.2022, respektivisht për 323 ditë të pranisë në punë të ia paguajë paditësve shumën 646.00 euro secilit, dhe në emër të kompensimit nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerë 27%, të një page bazë, të ia paguajë paditëses F.S., shumën prej 1,273.05 euro, dhe paditësit SH.S., shumën prej 1,496.61 euro, kanë kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj T.V., në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 12.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për t'i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj., ashtu që ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. Po ashtu i njëjti është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës.. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të

LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk janë kontestuese faktet si në vijim :

Për paditësen F.S., gjykata gjeti se e njëjta është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në institucionin parashkollor “...” në Gjakovë, si edukatore, paditësja për periudhën kohore prej 19.12.2019 deri me 09.02.2022 ka realizuar gjithsejtë 323 ditë pune, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga vërtetimi i lëshuar nga drejtori i shkollës së lartcekur. Paga bazë e saj është në lartësi prej 421.00 euro, fakt i vërtetuar përmes listave të pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021. E njëjta ka diplomuar me datë 24.04.2017 dhe ka marrë titullin bachelor i programit parashkollor, fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit, me numër 723 e lëshuar me datë 06.02.2017.

Për paditësin SH.S., gjykata gjeti se e njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “Luigj Gurakuqi” në Gjakovë, si drejtor i shkollës, dhe se për periudhën kohore prej 19.12.2019 deri me 09.02.2022 ka realizuar gjithsejtë 323 ditë pune, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga vërtetimi i lëshuar nga drejtori i shkollës së lartcekur. Paga bazë e tij është në lartësi prej 495.30 euro, sipas koeficientit 7.8, fakt i vërtetuar përmes listave të pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021. I njëjti ka diplomuar me datë 22.10.2010 dhe ka marrë titullin bachelor i gjeografisë-edukatës qytetare, fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit, me numër 193 e lëshuar me datë 22.11.2010.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.7 është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’u bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit është pjesërisht e themeltë, andaj bëri përlllogaritjen në atë mënyrë ditët e pranisë në punë 323 (për periudhën 19.12.2019- 09.02.2022) i ka shumëzuar me 2, duke ia njohur shumën prej 646.00 euro për

secilin paditës. Ndërsa sa i përket kërkesës së dytë, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 6 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Përqindja më e ulët dhe më e lartë e rritjes për secilën kategori dhe nivel të mësimdhënies (fillore dhe të mesme) sipas kualifikimit dhe përvojës është me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%-39%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura, paditësja F.S., ka diplomë universitare me titull bachelor i programit parashkollor dhe si dhe paditësi SH.S ka diplomë universitare me titull bachelor i gjeografisë- edukatë qytetare, rezulton se konform vendimeve të lartcekura, paditësve i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shpërblim jubilar, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Pretendimin e të paditurës dhënë në përgjigje në padi se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme dhe i vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, nga fakti se e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 19.12.2019 e deri me datë 09.02.2022 të njëjtit kanë punuar gjithsej 323 ditë pune, pra nuk e ka kontestuar as bazën e as lartësinë e kërkesëpadisë, por ka konsideruar se lidhur me këtë kërkesë të paditësit, e paditura nuk ka buxhet të mjaftueshëm, e që për gjykatën ky pretendim ishte irelevant dhe pa efekt juridik në mes të palëve, pasi që paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e lartcekur, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës

lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e kontratës së lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Në këtë rast gjykata e refuzoi kërkesën e paditësit SH.S., për kompensimin nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri me datë 21.02.2019, pasi që pretendimet e të autorizuarës së të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjykata i morri si të bazuara pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se paditësi kërkesën e tij për kompensimin për shpenzimet e ushqimit e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 22.02.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensimit nga marr dhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç’rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 332.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 156.00.-€, si dhe për përpilimin e parashtrësës për precizim shuma prej 156.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
- Departamenti i Përgjithshëm -
C.nr.160/22, me datë 22.04.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.